

# MJEDISI SOT

NUMËR 95 ■ DHJETOR 2004

BOTIM I PËRMUAJSHËM I QENDRËS RAJONALE TË MJEDISIT (REC) PËR EVROPËN QENDRORE DHE LINDORE - ZYRA NË SHQIPËRI

## 1994 - 2004 REC në Shqipëri



Aktivitetet e REC Shqipëri  
në vitin 2004

lexoni në faqen 7 ►



Menaxhimi mjedisor në  
qeverisjen vendore

lexoni në faqen 8-9 ►



Edukimi Mjedisor-kusht i  
ndryshimeve afatgjata

lexoni në faqen 10 ►

.....	3
<b>EDITORIAL</b>	
REC Shqipëri në prag të vitit 2005	
.....	5
<b>INFORMACIONI MJEDISOR</b>	
Paketa elektronike "Mjedisi Sot"	
Revista "Mjedisi Sot"	
<a href="http://albania.rec.org">http://albania.rec.org</a> - Një dritare e re informacioni	
.....	7
Aktivitetet e REC Shqipëri në vitin 2004	
.....	8-9
<b>NISMAT VENDORE</b>	
Menaxhimi mjedisor në qeverisjen vendore	
Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit	
.....	10
<b>EDUKIMI MJEDISOR-KUSHTI I NDRYSHIMEVE AFATGJATA</b>	
Paketa e Gjellbër në Shqipëri (Green Pack)	
"Mjedisi në qytetin tim" për Tiranën	
"Një mjedis më i mirë për fëmijë më të shëndetshëm"	
.....	12
<b>NË NXITJE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM</b>	
Burimet natyrore të përbashkëta – hapësira bashkëpunimi dhe mundësi zhvillimi për komunitetin	
Në mbështetje të komuniteteve vendore	
Zhvillimi i qëndrueshëm në zonën e Liqeneve të Prespës	
.....	14
Shqipëria dhe Konventa e Aarhusit	
.....	15
10 vjet histori e përbashkët	

Opinionet e shprehura në shkrimet e kësaj reviste nuk paraqesin domosdoshmërisht opinionet e Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC)

Kanë kontribuar për këtë numër:

**Stafi editorial**

Mihallaq Qirjo ■ Alken Myftiu ■  
Veton Kasapolli ■ Genta Hoxha ■  
Eduart Cani ■ Daniela Tola

Ky botim mbështetet financiarisht nga



Ambasada e  
Mbretërisë së Hollandës  
në Shqipëri



Qendra Rajonale e Mjedisit  
për Evropën Qendrore e Lindore  
Zyra në Shqipëri

# MJEDISI SOT

NUMËR 95 ■ DHJETOR 2004

MJEDISI SOT është një botim periodik të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) Zyra në Shqipëri

Në këtë botim të përnuajshëm do të gjeni informacion mbi probleme mjedisore, lajme të përzgjedhura, opinione e komente mbi çështje të mjedisit nga vendi e rajoni, informacione për aktivitete për mjedisin nga vendi e bota etj.

Versionin elektronik të kësaj reviste, mund ta gjeni në faqen: <http://albania.rec.org>  
Për të marrë "Mjedisi Sot", e përditshme elektronike, me postë elektronike apo revistën "MJEDISI SOT" (botim i përnuajshëm), dërgoni emrin dhe adresën tuaj pranë Zyrës së REC në Shqipëri, në adresat:

**Kutia Postare 127, Tiranë;**  
**Tel/Faks: (04) 239444;**  
ose [editor@albania.rec.org](mailto:editor@albania.rec.org)

## Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) për Evropën Qendrore e Lindore

është një organizatë ndërkombëtare jopartizane, joavokate, jofitimprurëse që mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore e Lindore (EQL), duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore.

REC është krijuar në 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot REC, bazohet ligjërisht në Kartën e tij, nënshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve në secilin prej 15 vendeve përfituese.

Shqipëria e ka nënshkruar Kartën e REC në 1993. Zyra e REC për Shqipërinë është hapur në 1994. Kjo zyrë punon për realizimin e misionit të REC duke mbështetur organizatat jofitimprurëse, institucionet mjedisore në të gjitha nivelet, dhe aktorë të tjerë të interesuar në fushën e mjedisit, duke mbështetur proceset pjesëmarrëse e shkëmbimin e lirë të informacionit.

Fushat kryesore të veprimtarisë janë: Programi i granteve për OJF-të; Planet Lokale të Veprimit në Mjedisi, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit për OJF-të dhe zyrtarë të mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj. Donatorët më të fundit janë: Komisioni Europian, Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, SIDA, UNDP, GEF/SGP, Fondacioni SOROS, SDC, etj.

<http://albania.rec.org>

NE VEND TE EDITORIAL-it

## REC Shqipëri në prag të vitit 2005

Është kënaqësi për mua të hap numrin e fundit të “Mjedisit Sot” për vitin 2004, i cili synon të paraqesë edhe një pamje të punës së Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) në Shqipëri për përmirësimin e mjedisit dhe fuqizimin e shoqërisë civile. Viti 2004 ka qenë një vit i ngarkuar dhe me shumë aktivitete. Ndryshimet në fushat e ndryshme të shoqërisë tonë kanë qenë më të vrullshme dhe intensive, duke kërkuar, nga të gjithë ne, përpjekje dhe përfshirje të reja në mbrojtje të kësaj pasurie kombëtare.

REC në Shqipëri, me mbështetjen e partnerëve tanë shqiptarë dhe rajonalë, përpiqet në mënyrë të vazhdueshme t'i paraprijë kërkesave të reja të ndryshimit dhe integritimit rajonal dhe atij evropian. Gjatë këtij viti, vëmendja kryesore është përqendruar në mbështetjen për nivel kombëtar dhe lokal për një mjedis më cilësor, duke rritur kapacitetet vendore në menaxhimin mjedisor, edukimin mjedisor dhe ndërgjegjësimin mbi ndikimin në shëndet.


REC Shqipëri ka përshtatur me largpamësi programet dhe burimet njerëzore me zhvillimet dhe kërkesat e vendit duke punuar në të gjitha nivelet. Mbi 35 bashki dhe komuna, disa Ministri dhe institucione qendrore dhe shumë partnerë rajonalë ballkanikë e më gjerë kanë bashkëpunuar me Zyrën e REC në Shqipëri, për zbatimin e projekteve konkrete mjedisore, shkëmbimin e përvojave kombëtare dhe rajonale në dobi të përmbushjes së detyrimeve të përbashkëta ndaj mjedisit.

Gjatë vitit 2004, REC Shqipëri mbështeti rreth 40 projekte mjedisore të shoqatave dhe pushteteve vendore me afërsisht 400,000 Euro, organizoi një Konferencë Kombëtare për shëndetin e fëmijëve dhe rreth 15 takime kualifikimi dhe diskutimi rreth çështjeve të ndryshme mjedisore, botoi periodikë dhe materiale të tjera të informacionit mjedisor, ndihmoi në hartimin e shumë planeve mjedisore, etj.

Në fund të këtij viti të suksesshëm dhe me shpresën për një mjedis më të mirë në të ardhmen, dëshiroj të falënderoj thellësisht partnerët dhe mbështetësit e REC për ndihmesën e dhënë, si dhe stafin e zyrës në Shqipëri për përkushtimin dhe pasionin e pashembullt në realizimin cilësor të rezultateve të mësipërme.


**Mihallaq Qirjo**  
*Drejtor i REC për Shqipërinë*





# Informacioni mjedisor

Mungesa e informacionit të vazhdueshëm mjedisor vazhdon të ndihet në opinionin e gjerë duke ndikuar direkt në nivelin e ndërgjegjes për mbrojtjen e mjedisit. “Mjedisi Sot” nisi rrugën e tij me synimin për të plotësuar një nevojë të pranuar nga mjaft institucione, organizata e individë lidhur me ‘etjen’ për informacion mjedisor aktual e të vazhdueshëm. Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) - Zyra në Shqipëri e ndërmori këtë nismë në vijim të përpjekjeve të saj për të mundur shpërndarjen e informacionit dhe për aftësimin dhe ndërgjegjësimin e aktorëve të përfshirë apo të interesuar për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.



## Paketa elektronike “Mjedisi Sot”

Paketa elektronike ditore “Mjedisi Sot”, që shpërndahet çdo ditë në 370 adresa elektronike, në fund të këtij viti shënon numrin e 1422 të saj.

Që prej vitit 2000, REC Shqipëri ofron këtë shërbim të informacionit elektronik. Paketa ditore përmban informacion mjedisor të mundur nga aktorët e përfshirë në problematikën mjedisore të vendit. Gjithashtu, problematika nga rajoni dhe bota është e pasqyruar me artikuj të marrë nga faqet e internetit dhe forumet informative në rrjet.

“Mjedisi Sot” elektronik siguron informacion mbi aktivitete, seminare, trajnime, kurse/shkolla verore etj. përmes rubrikës së njoftimeve duke plotësuar nevojat e të interesuarve në këto fusha.

## Revista “Mjedisi Sot”

Plotësimin e boshllëkut të informacionit vazhdon ta bëjë revista e përmuajshme “Mjedisi Sot”, që gjatë këtij viti ka ndryshuar pamjen dhe strukturën e informacionit. Këto ndryshime që i dhanë informacioneve mjedisore një koncept të ri u paraqitën në “Mjedisi Sot” që nga janari i vitit 2004. Revista filloi t’i kushtojë më shumë hapësirë dhe vëmendje fushave specifike mjedisore nga vendi dhe bota (ndryshimet klimatike, ujërat, turizmi, energjia etj.) dhe t’i japë më shumë rëndësi cilësisë se sa volumit të informacionit.

Gjatë 5 vjetëve të ekzistencës “Mjedisi Sot” ka arritur të kryejë me sukses misionin e programit të informacionit të REC, duke ofruar mundësinë e marrjes së informacionit dhe duke mbështetur

të tjerët në shkëmbimin e informacionit mjedisor. Shumë shpejt “Mjedisi Sot” u bë një nga burimet kryesore të informimit mbi atë që ndodh lidhur me mjedisin, duke u kthyer njëkohësisht dhe në një hapësirë diskutimesh e paraqitje opinionesh të ndryshme.

REC Shqipëri, që prej krijimit të tij, punon në fushën e informacionit mjedisor duke e konsideruar shkëmbimin e informacionit si mjet shumë të rëndësishëm për përfshirjen e publikut në çështjet e mjedisit dhe ngritjen e ndërgjegjes për mbrojtjen e mjedisit.

Gjatë këtij 5 vjeçari të janë përgatitur 95 numra të revistës mujore “Mjedisi Sot”, të cilët janë shpërndarë në rreth 250 adresa postare (ku përfshihen institucione të pushtetit qendror dhe vendor,

institucione akademike-shkencore, OJF, organizata ndërkombëtare, nxënës shkollash etj.)



## <http://albania.rec.org> - Një dritare e re informacioni

Website zyrtar është krijuar në fillim të këtij viti për t’u njohur me punën e REC - zyra Shqipëri. Vizitorët në mënyrë interaktive duke klikuar në faqen <http://albania.rec.org>, do të mund të gjejnë informacion mjedisor (lajme, botime të reja, biblioteka), të dhëna për projektet që REC zbaton në fushën e mjedisit, grantet kombëtare që REC ofron në ndihmë të shoqatave mjedisore, kontakte për aktorët e përfshirë në aktivitete mjedisore, etj. Këtë faqe e vizitojnë çdo ditë rreth 40 vizitorë.

REC SHQIPËRI  
JË URON



GËZUAR 2005

*Alken, Daniela, Dori, Djana, Edi, Genta, Kihallaq, Vetoni*

# Aktivitetet e REC Shqipëri në vitin 2004

**12 janar**

Konferencë Kombëtare për monitorimin e mjedisit

**12 shkurt**

Promovohet vëllimi i tretë i botimit "Akte ligjore mjedisore në Shqipëri"

**18 shkurt**

Takim pune me ekspertë mbi përgatitjen e "Paketa e Gjellbër në Shqipëri"

**20 shkurt**

Botohet buletini lokal për Liqenin e Shkodrës, në kuadër të projektit për "Liqenin e Shkodrës"

**26 shkurt**

Ligjet mjedisore shqiptare, paraqiten të plota në internet [albania.rec.org](http://albania.rec.org)

**27 shkurt**

Përgatitet broshura informuese "Shqipëria në marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore"

**2 mars**

Në Shkodër zhvillohet takimi dypalësh shqiptaro-malazez për Liqenin e Shkodrës

**5 mars**

Botohet për herë të parë buletini i ri tregjuhësh për Liqenin e Shkodrës

**17 - 18 mars**

Takime me mësuesit e shkollave tetëvjeçare rreth botimit "Mjedisi në qytetin tim"

**9 prill**

Publikohet Strategjia Rajonale për Zhvillimin e Ekoturizmit në zonën e Prespës

**22 prill 2004**

Zhvillohet takimi i hapjes së projektit "Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Bashkinë Pogradec"

**prill - maj**

Aktivitete njohëse mbi Planin kombëtar për shëndetin dhe mjedisin e fëmijëve zhvilluar në Tiranë, Elbasan, Pogradec, Shkodër dhe Vlorë

**maj 2004**

Gazetarët shkodranë dhe malazez në një trajnim për mjedisin

**7 maj**

Takimi promovues për fillimin e procesit të përgatitjes së Objektivave për Zhvillimin e Mijëvjeçarit në Lezhë

**6 tetor**

Zhvillohet Konferenca kombëtare "Një mjedis më i mirë për fëmijë të shëndetshëm", në kuadër të CEHAP

**qershor 2004**

Takime mes fëmijëve të shkollave 8-vjeçare dhe të mesme të Shqipërisë me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Mjedisit

**8 korrik**

Takim promovues i projektit për përgatitjen e Raporti Rajonal për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit për Qarkun e Korçës

**21 korrik**

Seminar ndërgjegjësues: "Hapësirat e punës - miqësore me mjedisin: Të gjithë mund të kontribuojnë!"

**7 shtator**

Botohet libri për edukimin mjedisor "Mjedisi në qytetin tim" per Tiranen

**27 shtator**

Promovohet libri «Mjedisi në qytetin tim», i cili iu shpërndahet të gjitha shkollave tetëvjeçare të Tiranës

**21 dhjetor**

Seminar në Shkodër "Njohja e Legjislacionit mjedisor, parakusht për zbatimin e tij"

**26 nëntor**

Takim i hapur publik mbi përgatitjen e analizës së problemeve mjedisore në kuadër të PLVM për Pogradecin

**21 tetor**

Botohet fotoalbumi për Liqenin e Shkodrës, me titull: "Vlera që s'vdesin - Liqeni i Shkodrës në fotoalbum"

**29 tetor**

Takim ballkanik për Përgatitjen e Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis në vendet e Europës Juglindore

**17 - 23 nëntor**

Trajnime për edukimin mjedisor me mësues të shkollave tetëvjeçare të Tiranës

**23 dhjetor**

Seminar në Shkodër "Njohja e Legjislacionit mjedisor, parakusht për zbatimin e tij"

# Menaxhimi mjedisor në qeverisjen vendore

*Vetëm vitet e fundit, institucionet e pushtetit vendor kanë rritur interesin e tyre në përgatitjen e strategjive të zhvillimit dhe nxjerrjes së prioriteteve mjedisore në komunitetet e tyre me anë të një analize profesionale. Hartimi dhe përgatitja e tyre është një proces i gjerë bashkëpunimi, i cili përballet ende me probleme të koordinimit gjatësektorial dhe krijimit të frymës gjithëpërfshirëse me aktorë të tjerë në komunitet.*



## Planet Lokale të Veprimit në Mjedis

Si përgjigje e nevojës së qeverisjes vendore, Planet Lokale të Veprimit në Mjedis forcojnë bashkëpunimin mes institucioneve vendore dhe komunitetit, nxitjen e dialogut mes tyre, rritjen e kapaciteteve vendore në të mirë të financimit dhe krijimit dhe identifikimit të burimeve njerëzore si dhe zgjerimin e mundësive financiare.

Me pasuri të mëdha natyrore dhe burime të rëndësishme për zhvillim, Qarku i Korçës është përfshirë në përgatitjen e këtyre planeve duke i ardhur kështu në ndihmë proceseve të shpejta të zhvillimit në këtë Qark.

Bashkitë që janë përfshirë në përgatitjen e PVLMeve, duke filluar nga viti 2004 e që shtrihen deri në vitin 2007, janë Bashkia e Korçës, Pogradecit, Maliqit, Bilishtit, Ersekës dhe Leskovikut. Nga të cilat Korça dhe Pogradeci janë përfshirë në vitin e parë, Bilishti dhe Maliqi në vitin e dytë ndërsa në vitin e tretë Erseka dhe Leskoviku.

Në fillim të këtij procesi janë ngritur grupe pune të përbërë nga ekspertë vendorë të cilët punojnë në fusha të ndryshme të problematikës mjedisore, të cilët përfaqësojnë bashkinë, drejtoritë e ndryshme, OJFtë, biznesin, etj.

Faza e parë e procesit është përgatitja e dokumentit të PVLMeve duke bërë një analizë të situatës që të krijohet një vizion për të ardhmen në mënyrë që të identifikohen problemet mjedisore dhe të renditen sipas planit konkret të ndërhyrjeve.

Financimi i projekteve të identifikuar nga plani për zgjidhjen e problemeve mjedisore është faza e dytë e procesit, ku REC dhe SIDA mbështesin me fonde bashkitë, të cilat do të japin 10% të fondit si bashkëfinansim, për të rritur bashkëpunimin dhe përfshirjen e njësive vendore.

Për të rritur ndërgjegjen qytetare rol të rëndësishëm ka edhe përfshirja e OJFve mjedisore me aktivitete të ndryshme si dhe OJFtë e grave për të rritur rolin e grave në proceset vendimmarrëse.



# Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit

*Edhe pas fillimit të procesit të decentralizimit në Shqipëri, qeverisja vendore ende po përballlet me probleme dhe vështirësi në plotësimin e qëllimeve dhe përgjegjësi. Strategjitë e zhvillimit dhe paketa e prioritetëve nuk janë përgatitur dhe kjo konsiderohet si arsyeja kryesore e nivelit të ulët të ndihmave nga brenda dhe nga jashtë për zhvillimin vendor.*

Shqipëria, si pjesë e procesit afatgjatë të reformave, ka filluar të integrojë Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) në kornizat kombëtare të zhvillimit. Në kuadër të këtij procesi, tashmë pothuajse të gjitha qarqet e Shqipërisë kanë përgatitur ose janë në përfundim të përgatitjes së Raportëve të tyre Rajonale mbi OZHMtë.

Me mbështetjen e UNDPsë në Shqipëri, Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore – Zyra Shqipëri ndihmon në përgatitjen e këtyre raporteve në Qarkun e Korçës dhe Lezhës.

Ky proces ka si qëllim përmirësimin e kapaciteteve të qeverisjes vendore të planifikimit afatgjatë si dhe krijimit të një vizioni bashkëkohor drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe rritjes ekonomike në linjë me OZHMtë. Në fillim të procesit krijohet fondi për debate publike

që forcon lidhësinë vendor, dhe mobilizimi i mbështetjes. Strukturat e zbatimit të aktiviteteve përbëhen nga ekspertë vendorë të të gjitha fushave dhe me pjesëmarrje të gjerë nga institucionet vendore në të gjithë Qarkun, shoqërisë civile, medias, biznesit dhe aktorëve të tjerë.

Qarqet e Korçës dhe Lezhës kanë përgatitur tashmë draft raportet e tyre, ku është bërë një analizë e hollësishme e gjendjes dhe janë përcaktuar qëllimet, objektivat, treguesit dhe plani i aktiviteteve për përmbushjen e objektivave.

Grupi i specialistëve me ndihmën e REC dhe me një diskutim të gjerë në publik, po punojnë për përfundimin e këtyre dokumenteve strategjike për këto dy rajone të rëndësishme të vendit.



## Qarku Lezhë – OZHMtë

1. Zhdukja e varfërisë ekstreme dhe urisë
2. Kryerja universale e arsimit fillor
3. Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas
4. Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore dhe përmirësimi i shëndetit të nënës
5. Garantimi i qëndrueshmërisë së mjedisit

## Qarku Korçë - OZHMtë

1. Zhdukja e varfërisë ekstreme dhe urisë
2. Kryerja universale e arsimit fillor
3. Nxitja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i rolit të gruas
4. Zvogëlimi i vdekshmërisë foshnjore
5. Përmirësimi i shëndetit të nënës
6. Lufta ndaj virusit HIV/AIDS, malarjes dhe sëmundjeve të tjera
7. Garantimi i qëndrueshmërisë së mjedisit
8. Zhvillimi i partneritetit global
9. Mirëqeverisja



# Edukimi Mjedor-kusht i ndryshimeve afatgjata

Mjedisi dhe mbrojtja e mjedisit vazhdojnë të konsiderohen si çështje që i takojnë “shtetit” dhe “të tjerëve”, dhe jo si çështje individuale dhe komunitare. Zhvillimi i shoqërisë civile e sidomos i lëvizjes mjedisorë gjatë dekadës së fundit, treguan se edukimi qytetar dhe mjedor është fusha ku duhet të punohet më shumë.

Edhe pse shpesh është theksuar që edukimi mjedor në Shqipëri është në një nivel të ulët, do të ishte më e saktë të thuhet se nuk ekziston një kurrikulë e veçantë për këtë lloj edukimi në programin shkollor.

Deri tani, ka përpjekje serioze për të futur njohuri të reja lidhur me mjedisin, mirëpo ato kanë arritur të organizohen vetëm në kuadër të pak lëndëve dhe të pakoordinuara. Në Shqipëri mungon strategjia dhe prioritetet për edukimin mjedor në shkollë. Tre janë arsyet kryesore për rëndësinë e edukimit mjedor:

a) Edukimi mjedor si prioritet për edukimin qytetar të shoqërisë shqiptare, b) Edukimi mjedor si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm, sepse me një edukatë mjedisorë mund të menaxhosh më mirë burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme dhe, c) Edukimi mjedor si Objektiv i Zhvillimit të Mijëvjeçarit (MDGve) për zhvillimin kombëtar të vendit.

## Paketa e Gjelbër në Shqipëri (Green Pack)



Çdo ditë e më shumë edhe në vendin tonë, lëvizja mjedisorë dhe edukimi mjedor i komunitetit shihen si përparësi. Në ndihmë të këtij edukimi në Shqipëri, REC ka punuar dhe po punon për përgatitjen në shqip të “Paketës së Gjelbër”. Kjo është një paketë edukative për fëmijët e shkollave të moshave 11-15 vjeç, e para e këtij lloji në Shqipëri, e cila e sjell edukimi mbi zhvillimin e qëndrueshëm si një koncept të gjerë, me dimensione ekonomike, sociale, mjedisorë, duke e konsideruar thelbësor për t’u marrë në konsideratë në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

“Paketa e Gjelbër”fokuson në mënyrë të veçantë aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshin një numër të madh materialesh edukative. Ajo formon vlera të reja tek nxënësit si dhe ngre një model të ri sjellje në shkollë, shtëpi dhe shoqëri. Nxënësit janë partnerë me mësuesit në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, diskutim dhe vendimmarrje. Mesazhet kryesore të kësaj pakete shpërndahen nëpërmjet nxënësve dhe mësuesve, në mënyrë shumë efektive dhe tek anëtarët e tjerë të familjes dhe shoqërisë. Paketa e Gjelbër përmban 22 tema në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të ndara në 5 kapituj. Pritet që procesi i përgatitjes të përfundojë në prag të vitit të ardhshëm shkollor 2005-2006



## “Mjedisi në qytetin tim” për Tiranën

Synimi që nxënësit e shkollave tetëvjeçare të plotësohen me njohuri dhe koncepte të reja për mjedisin urban si dhe aktivizimi i tyre në veprime konkrete brenda dhe jashtë shkollës, solli që REC të përgatisë dhe botojë librin “Mjedisi në qytetin tim”. Libri përmban informacione për edukimin mjedor në zonat urbane dhe është një nismë e Bashkisë së Tiranës dhe PNUD-it, ndërsa është mbështetur nga Drejtoria Arsimore e Tiranës.

Libri synon të jetë pjesë aktive e edukimit mjedor në shkollat tetëvjeçare. Përmes diskutimit dhe debatit mbi problematikën mësimore, ky botim synon të luajë rolin e promovuesit për përgjegjësinë qytetare ndaj mjedisit ku jetojmë, duke plotësuar kështu formimin e përgjithshëm qytetar të individëve në komunitetet ku jetojnë.

Në datën 20 Shtator u organizua ceremonia e promovimit të këtij libri si dhe u bë shpërndarja e tij në 53 shkollat e qytetit të Tiranës. REC organizoi edhe disa trajnime me mësuesit me qëllim zgjerimin e njohurive të tyre me konceptet e reja të edukimit mjedor, që ky libër sjell për rritjen e ndërgjegjësimit mjedor tek brezi i ri.




## “Një mjedis më i mirë për fëmijë më të shëndetshëm”

*Fushatë ndërgjegjësimi në kuadër të Konferencës Ministrore, Budapest qershor 2004*

Popullsia e Shqipërisë është më e reja në Evropë me një mesatare të moshës prej 28.6. Një e treta e popullsisë (33 %) është nën 14 vjet, rreth 40 për qind janë të moshës 18 vjeçare, ndërsa nën moshën 25 vjet janë gati gjysma e popullsisë.

Mosha e re e popullsisë së Shqipërisë rrit rëndësinë e zbatimit të Planit të Veprimit për Shëndetin dhe Mjedisin për Fëmijët CEHAP, si dokument strategjik i cili synon përmirësimin e kushteve mjedisore dhe shëndetësore ku jetojnë fëmijët. Në kuadër të njohjes me CEHAPE si një dokument evropian i miratuar në Konferencën Ministrore në qershor 2004, në Budapest, REC ka organizuar, gjatë vitit 2004, fushatën ndërgjegjëse “Një mjedis më i mirë për fëmijë më të shëndetshëm”. Në kuadër të kësaj fushate u organizuan një sërë aktivitete kombëtare mbi mjedisin dhe shëndetin e fëmijëve. Aktivitetet e organizuara në rrethet Tiranë, Vlorë, Elbasan, Shkodër, Pogradec me nxënës dhe mësues të shkollave tetëvjeçare si dhe takime me ministrat e Shëndetësisë dhe Mjedisit, synonin krijimin e një klime diskutimi të qeverisë shqiptare me opinionin publik përpara ndërmarrjes dhe nënshkrimit të detyrimeve ndërkombëtare.

Në datën 6 tetor 2004 u organizua konferenca kombëtare me temë “Një mjedis më i mirë për fëmijë më të shëndetshëm”. Kjo konferencë kishte si qëllim rritjen e bashkëpunimit midis institucioneve vendimmarrëse dhe aktorëve të ndryshëm që punojnë në fushën e mjedisit dhe shëndetit, për t’u fokusuar më tepër në shëndetin e fëmijëve, dhe ndikimin e mjedisit mbi ta.



## Programi i kualifikimit të drejtuesve të rinj për mjedisin

### Programi për 2005 - 2006

Periudha e trajnimit	Afati i aplikimit
31 Janar – 26 Shkurt 2005	3 dhjetor 2004
4 – 30 Prill 2005	18 shkurt 2005
5 Shtator – 1 Tetor 2005	15 korrik 2005
30 Janar – 24 Shkurt 2006	25 nëntor 2005
8 Maj – 2 Qershor 2006	17 shkurt 2006

Forma e aplikimit në internet [www.rec.org/REC/Programs/Young EnvLeaders.html](http://www.rec.org/REC/Programs/Young_EnvLeaders.html).

# Në nxitje të zhvillimit të qëndrueshëm

Zhvillimi i qëndrueshëm nuk është më një ide abstrakte e marrëveshjeve ndërkombëtare, deklaratave politike apo librave shkencorë, por është një realitet me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën tonë. Guri themeltar i zhvillimit të qëndrueshëm është mjedisi, me të cilin lidhen siguria njerëzore, prosperiteti dhe mirëqenia sociale. Nëse ne përdorim burimet natyrore në mënyrë të qëndrueshme, parandalojmë ndotjen dhe nëse ruajmë habitatet natyrore, atëherë kemi kontribuar në zhbutjen e varfërisë dhe ngritjen e cilësisë së jetës. Për të munduruar zbatimin e zhvillimit të qëndrueshëm, proceset ndërkombëtare kanë filluar të koordinojnë përpjekjet midis komunitetit ndërkombëtar dhe vetë vendeve. Shqipëria, së bashku me vendet tjera të Ballkanit, ka shumë mundësi dhe pengesa për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm. Procesi i tranzicionit u jep mundësinë këtyre shteteve të krijojnë institucione dhe të zhvillojnë legjislacionin në aspektin mjedisor dhe të përdorin shoqërinë e re civile për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm. Të gjithë këta faktorë duhet të kihen parasysh nga qeveritë dhe OJF-të gjatë planifikimit për qëndrueshmëri në të ardhmen. Roli i OJF-ve në Shqipëri, si kudo në Europën Qendrore dhe Lindore, njihet si shumë i rëndësishëm për bërjen e zhvillimit të qëndrueshëm pjesë të çështjeve kryesore të zhvillimit.

Gjithashtu, grupet lokale dhe kombëtare kanë zbatuar drejtpërdrejtë projekte pilot për të treguar zhvillimin e qëndrueshëm në praktikë.

## Burimet natyrore të përbashkëta – hapësira bashkëpunimi dhe mundësi zhvillimi për komunitetin

Shkodra me Liqenin e saj, është një nga rajonet ku çështja e mirëmenaxhimit të burimeve natyrore të përbashkëta ka rëndësi të veçantë pikërisht për cilësinë e jetesës së banorëve dhe të marrëdhënieve dypalëshe mes Shqipërisë dhe Malit të Zi. Vëmendje e veçantë po i kushtohet përdorimit të qëndrueshëm të burimeve në Liqenin e Shkodrës duke iu përgjigjur kështu nevojave të aktorëve të ndryshëm në shfrytëzimin e vlerave të Liqenit. Mbështetja e REC Shqipëri dhe e SDC gjatë fazës së parë trevjeçare dhe në vijim, për strukturat e qeverisjes vendore, institucionet kërkimore shkencore, autoritetet mjedisore, OJF-të dhe komunitetin bëhet për të nxitur bashkëpunimin mes tyre dhe sidomos atë ndërkufitar për përdorim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave të Liqenit. Gjatë vitit 2004, REC është përqëndruar në disa drejtime kryesore:

### Forcimi i kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm vendorë,

- Trajnim intensiv për përgatitjen e Planeve Lokale të Veprimtimit në Mjedis, për përfaqësuesit e

qeverisjes vendore të Shkodrës dhe bashkive e komunave përreth liqenit, përfaqësues të strukturave dhe institucioneve të ndryshme vendore, shoqërisë civile, etj;

- Trajnim profesional për gazetarinë mjedisore, me pjesëmarrjen e gazetarëve e reporterëve të mediave lokale e kombëtare në Shkodër dhe Mal të Zi
- Trajnim për OJF-të lokale shqiptare e malazeze për përgatitjen dhe menaxhimin e projekteve, marrëdhëniet me donatorët dhe mirëfunksionimi i rrjeteve të OJF-ve

### Edukimi mjedisor

Fëmijët, të rinjtë dhe shkolla kanë qenë në fokus të aktiviteteve në kuadër të projektit për njohjen e vlerave natyrore dhe problemeve mjedisore të Liqenit. Janë zhvilluar takime të përbashkëta të të rinjve shqiptarë e malazezë për të njohur më mirë problematikat dhe për të munduruar përpjekjet e përbashkëta për mbrojtur vlerat e një pasurie të përbashkët.

<http://www.rec.org/REC/Programs/REREP/Biodiversity/SkadarActivities.html>

<http://albania.rec.org/Projects/Biodiversiteti/Bio%20main.html>



## Në mbështetje të komuniteteve vendore

Viti 2004 ka pasur zhvillime mjaft të rëndësishme në drejtim të fokusimit për çështje mjedisore në nivel vendor dhe komunitar. Duke ndjekur me vëmendje dhe me interes, zhvillimet e shoqërisë shqiptare në përgjithësi, REC në Shqipëri ka ndërmarrë një numër të konsiderueshëm aktiviteteve në mbështetje të strukturave vendore dhe komuniteteve në nivel lokal dhe komunitar.

Një fushë e rëndësishme e këtyre aktiviteteve kanë qenë mbështetja e drejtpërdrejtë për përmirësime cilësore të mjedisit nëpërmjet Programit të Granteve të REC, të mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës dhe Zyra EuropeAid e Komisionit Evropian. Duke synuar që koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm të mos mbetet një koncept virtual por të gjejë zbatim në praktikë, grantet e mbështetura kanë synuar futjen e mënyrave të qëndrueshme të përdorimit të burimeve natyrore, përmirësimin konkret të mjedisit ku jetojnë njerëzit, promovimin dhe nxjerrjen në pah të vlerave natyrore, kulturore e historike

si dhe përmirësimin e menaxhimit të këtyre vlerave.

Bashkëpunimi efektiv ndërmjet komunitetit dhe strukturave të ndryshme, përfshirja e banorëve në vendimmarrje dhe përpjekjet për përmirësimin e mjedisit ka qenë një tjetër aspekt i këtyre granteve të mbështetura në të gjithë Shqipërinë.

Disa nga grantet e mbështetura nga REC gjatë vitit 2004 janë: përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza në Milot, mbrojtja dhe ripërtëritja e Amenit në Lurë, përmirësimi i mjedisëve në qendër të komunës së Mirasit, promovimi i vlerave natyrore të Luginës së Valbonës, përmirësimi i menaxhimit të parkut të Viroit, gjelbërimi i rrugëve të rikonstruara në Tiranë, përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave urbane në Sukth etj.



### Grantet në shifra gjatë 2004

#### Shpërndarje gjeografike:

*Kukës, Peshkopi, Vorë, Lurë, Milot, Pukë, Gjirokastrë, Tiranë, Himarë, Divjakë, Kelmend, Zall-Bastar, Elbasan, Burrel, Shkrel, Priskë, Krutje, Tropojë, Shkodër, Berat, Fushë-Arrëz, Sukth, Miras, Ersekë, Rrëshen, Malzë, Manëz, Lezhë,*

**Numri i granteve, 44 grante në të gjithë Shqipërinë, Shuma totale: 400,000 EURO**

## Zhvillimi i qëndrueshëm në zonën e Liqeneve të Prespës

Ndër rajonet e para ku ka filluar zbatimi i strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm është rajoni i Liqeneve të Prespës. Si një nga pasuritë natyrore me vlera të jashtëzakonshme të larmisë natyrore dhe mundësive turistike, ky rajon ka qenë gjithmonë në vëmendjen e pushtetit qendror dhe vendor.

Duke pasur parasysh nevojën më të madhe që paraqet zona, atë të zhvillimit turistik të qëndrueshëm, Qendra Rajonale e Mjedisit ka ndërmarrë një sërë nismash për të përgatitur strategji konkrete zhvillimi në fushën e ekoturizimit dhe të marëdhënieve komunitet - natyrë.

Nisma e përbashkët të REC Shqipëri me REC Maqedoni gjatë viteve 2003 - 2004 është përgatitja e Strategjisë për zhvillimin e Ekoturizimit në zonën e Prespës, duke angazhuar të gjithë aktorët vendor nga të dyja

anët. Duke siguruar përfshirjen e qeverisjes vendore, shkollave, OJFve, bizneseve etj., të cilët nxorren në sipërfaqe nevojat e zonës dhe hartuan një plan veprimi konkret për mundësitë e zhvillimit eko-turistik të zonës.

Këto nisma kanë dalë si nevojë për përgatitjen e rrugëve të zhvillimit që në të njëjtën kohë respekton natyrën në mënyrë të qëndrueshme. Kjo zonë është shpallur Zonë e Mbrojtur si nevojë e paraqitur për menaxhimin e saj si një të tërë.

Gjithashtu, REC në bashkëpunim me PNUDin, ka hartuar një analizë të hollësishme të të gjithë faktorëve që veprojnë në zonë, duke u fokusuar në bashkëveprimin ndërmjet tyre, në gjetjen e rekomandimeve të sakta për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik që respekton natyrën.



# Shqipëria dhe Konventa e Aarhusit

Shqipëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të nxitur pjesëmarrjen e publikut në mbrojtjen e mjedisit, që do të thotë edhe zbatimin në praktikë të parimeve të Konventës së Aarhusit në realitetin shqiptar. Që nga koha e ratifikimit të Konventës së Aarhusit, disa vjet më parë nga Kuvendi i Shqipërisë, në vend janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm ligjorë në fushën e mjedisit dhe të drejtave mjedisore. Vete ratifikimi i Konventës ishte rrjedhojë logjike e një pjesëmarrjeje mjaft aktive në procesin “Mjedisi për Europën”. Qendra Rajonale e Mjedisit – Shqipëri e ka radhitur Konventën e Aarhusit dhe pjesëmarrjen e publikut ndër fushat kryesore të punës gjatë vitit 2004 dhe më tej. Gjatë kësaj kohe REC ka organizuar aktivitete të ndryshme siç janë trajnimet me OJFtë, qeverisjen vendore dhe aktorë të tjerë, ofrimi i mbështetjes për nisma të ndryshme të shoqërisë civile për pjesëmarrje dhe dialog me vendimmarrësit. Ndër arritjet kryesore në këtë fushë ka qenë përgatitja e Strategjisë dhe planit të veprimit për zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri. Me miratimin përfundimtar të kësaj strategjie një sërë detyrash dhe përgjegjësisht të rëndësishme do të shtrohen për të gjithë strukturat, institucionet dhe organizmat e ndryshëm, shoqërinë civile, etj.

Puna që mbetet të bëhet në vitet në vazhdim është zbatim i efektiv i kësaj strategjie që është dhe faza më e rëndësishme për mjedisin shqiptar, meqë synohet pjesëmarrja e publikut në mbrojtjen e mjedisit duke e bërë atë çështje të mbarë komunitetit. REC Shqipëri dhe në rajon e konsideron mbështetjen për aktivitetet e kësaj fushe, si një kontribut me vlerë në të ardhmen.



Qytetarë të Tiranës në protestën “Stop plehrave në Shqipëri”  
Foto: REC/E. Cani

**Konventa për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin**

**Botime të REC në kuadër të programit të pjesëmarrjes publike**



# 10 vjet histori e përbashkët

Përsëritje dhe urime nga disa prej kolegëve dhe bashkëpunëtorëve që kanë dhënë kontributin e tyre gjatë këtyre dhjetë vjetëve të REC në Shqipëri. Kudo që ndodhen, ata mbeten pjesë e arritjeve dhe sukseseve të përbashkëta. Me këtë faqe-kartolinë, përcjellim urimet tona të përzemërta për të gjithë kudo që ndodhen!

*Gjithë stafit, bashkëpunëtorëve dhe dashamirësve të REC në Shqipëri e më gjerë i uroj nga zemra Gëzuar Vitin e Ri 2005! REC i uroj vazhdimësi e shumë suksese në veprimtarinë e tij të palodhur në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri.*

**Blerta Maliqi**

**Gjenevë, Zvicër**

*Është kënaqësi për mua t'i përcjell REC urimet e mia dhe, njëkohësisht, ndiehem i vlerësuar si pjesë e historisë dhjetëvjeçare të REC në Shqipëri. Urime për gjithë stafin e REC në këto dhjetë vjet dhe njëkohësisht për komunitetin, familjen e madhe të REC, që mundësuan arritjet dhe sukseset në këto vite.*

*Uroj dhe besoj se tradita mjedisore do të vazhdojë e tillë dhe në vitet në vijim. Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri. Përsëritje,*

**Rezart Xhelo**

**Toronto, Kanada**

*10 vite të aktivitetit të REC në Shqipëri duken sikur janë shumë edhe pak. Duket sikur janë shumë kur kemi parasysh produktin e madh të REC në fushën e mbrojtjes së mjedisit në Shqipëri. REC ka qenë një nga organizatat më aktive në këtë fushë, veçanërisht në ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e publikut. Kontributi i tij në hartimin dhe zbatimin e strategjive, politikave e planeve të veprimit në fushën e mjedisit, roli promotor në aktivizimin e sektorit të OJF-ve mjedisore dhe në bashkëpunimin rajonal, ka lënë gjurmë shumë të rëndësishme në fushën e mjedisit në Shqipëri. 10 vite duken pak, sepse kënaqësia e të punuarit në REC e shkurton këtë kohë. Organizimi i punës, mënyra mjaft efikase e të punuarit në grup, korrektësia dhe ngrohtësia mes kolegëve, të bën të ndjehesh mirë mes stafit të REC. Urimet më të mira!*

**Sajmir Beqiraj**

**Tiranë**

*Të dashur kolegë dhe dashamirës të REC Gëzuar Krishtlindjet dhe Vitin e Ri.*

*10 vjet ndikim në lëvizjen mjedisore mbase mund të duken pak, por 10 vjet REC në lëvizjen mjedisore shqiptare është një ndryshim shumë i madh. Shumë urime dhe suksese në të ardhmen!*

**Ermira Lubani**

**Toronto, Kanada**

*Të bëhesh pjesë e historisë 10 vjeçare të REC, si një lëvizje e suksesshme mjedisore në Shqipëri, të bën të ndjehesh mirë. Edhe pse e shkurtër, koha e kaluar si pjesë e stafit të REC më ka mundësuar të kontribuoj në misionin e*

*veshtirë të mbrojtjes së mjedisit. Gëzuar 10 vjetorin e REC Shqipëri dhe Gëzuar Vitin e Ri 2005!*

**Besnik Baka**

**Sarajevë, B & H**

*Përsëritje!*

*Puna me ju, ka qenë vërtetë kënaqësi e veçantë. Po kështu, edhe mundësia që më jepet që në këtë fundviti dhe me rastin e përvjetorit të 10-të të REC, t'ju uroj suksese të mëtejshme. Vazhdoni të punoni me entuziazmin që ju karakterizon, për të përmbushur misionin tuaj!*

**Oltiana Thomai**

**Tiranë**

*Përsëritje të përzemërt personazheve të REC, shpërndarë a përmbledhur. Mirënjohje për strukturën që mundësoi kanalizimin e energjive tona për të kontribuar një tullë më shumë në atë dhe këtë kohë ndryshimesh të realiteteve dhe vetvetes.*

*Gëzuar përvjetorët!*

**Kaman Çipi**

**St. Louis, ShBA**

*Gëzuar Vitin e Ri 2005 - Vit të mbarë dhe plot aktivitete për të përmbushur misionin dhe kontribuar në përmirësimin e mjedisit Shqiptar!*

*Është kënaqësi të kesh qenë apo të jesh staf i REC-ut për një periudhë kohe, sidomos në fillimet e çdokujt pasi informacioni, njohjet dhe atmosfera e punës që të krijohen ndikojnë mjaft në formimin e aftësive profesionale të çdokujt*

*Kujtime dhe mbresa mjaft të mira kam nga puna ime e parë në REC, që ndonëse e shkurtër ka ndikuar në zgjimin e interesit për shoqërinë civile, në përkushtimin për mjedisin dhe mbi të gjitha në krijimin e një fryme grupi që çdokush do ta kishte zili.*

*Urimet më të mira për REC në 10-vjetorin e tij - Punë të gjatë dhe mbështetje më të madhe për organizatat mjedisore!*

**Valbona Mazreku**

**Tiranë**



Head Office



Kërko



Kontakt



In English



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT  
për Evropën Qendrore e Lindore

## Rrjeti i zyrave të RECut REC Shqipëria



### 10 vjet REC Shqipëri

REC Shqipëri është futur në vitin e 10 të punës së tij në Shqipëri.

Zyra e REC për Shqipërinë është hapur në 1994. Kjo zyrë punon për realizimin e misionit të REC duke mbështetur organizatat jofitimprurëse,

institucionet mjedisore në të gjitha nivelet, dhe aktorë të tjerë të interesuar në fushën e mjedisit, duke mbështetur proceset pjesëmarrëse e shkëmbimin e lirë të informacionit. Fushat kryesore të veprimtarisë janë: Programi i granteve për OJF-të; Planet Lokale të Veprimit në Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit për OJF-të dhe zyrtarë të mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj. Donatorët më të fundit janë: Komisioni Europian, Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, SIDA, UNDP, GEF/SGP, Fondacioni SOROS, SDC, etj.

### Strategjia Evropiane e Ruajtjes së Bimeve Ne Shqip




REC Shqipëri, ka perkthyer ne shqip, Strategjine Evropiane te Ruajtjes se Bimeve, nje nisme e Planta Europa dhe e Keshillit te Evropes, ne kuader te Strategjise Boterore, per kete qellim. Merrni versionin perfundimtar duke shtypur mbi foto.

**shtypni mbi foto**

### Liber per edukimin mjedisor



Me nismen e Bashkise se Tiranes, REC Shqipëri pergatiti per shkollat 8-vjecare te Tiranes librin e edukimit



### Numri 94 i "Mjedisi Sot" Nentor 2004 (format.pdf)

Nëse doni të dini më shumë për mjedisin në Shqipëri

### Lexoni lajmet mjedisore ditore "Mjedisi Sot" Nr. 1412 dt. 13/12/2004

### Ndotja nga transporti, pasojat sociale dhe nje takse spekulative Mjedisi Sot >>>

Transporti dhe mjedisi  
Progresi i shoqërisë moderne nuk mund të konceptohet pa veprimtarinë e transportit. Por intensiteti gjithmonë rritje i levizjes së mallrave dhe të njerëzve me mjetet e transportit ajror,

<http://albania.rec.org>

Ç'është REC

Programet

Grante

Biblioteka

Aplikime  
dhe  
Njoftime

Adresarë

Adresa të  
tjera

Foto nga  
Shqipëria